



Nr. 822/7 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, me 24.03.2023

VENDIM

Nr. 13 datë 24.03.2023

PËR  
PAGESËN E ORËS MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR  
(PERSONALITETE AKADEMIKE TË HUAJ) PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 04, datë 17.03.2023 "Për miratimin e planbuxhetit vjetor 2023", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Pagesën e personelit akademik të ftuar (në cilësinë e personaliteteve të huaja) me 5 fishin e pagesës orare të titullit apo gradës për orët mësimore në vitin akademik 2022-2023.
2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve për vitin 2023.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi: Administratori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Njësitë kryesore, Njësitë bazë.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BORDIT  
ARDIAN DURMISHI